

VENDIM
Nr.550, datë 11.8.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.748, DATË 11.6.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHITESA MBI PAGË TË PUNONJËSVE
TË PERSONELIT AKADEMIK TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT TË
LARTË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr.10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.748, datë 11.6.2009 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:
 - a) Lidhja nr.1 “Struktura dhe nivelet e pagave, sipas kategorive të vendeve të punës, për nëpunësit e institucioneve publike të arsimit të lartë”, zëvendësohet me lidhjen nr.1 me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
 - b) Në fund të pikës 5, pas fjalëve “... për këtë periudhë”, shtohen fjalët “... dhe jo më shumë se 9 mbledhje në vit...”.
 - c) Në pikën 9, pas fjalëve “... me kontratë ...”, shtohen fjalët “... nga kategoria “Akademik” dhe kategoria “Profesor”...”.
 2. Efektet financiare për paga e sigurime shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga fondet e institucioneve të arsimit të lartë, për vitin 2011.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E PERSONELIT AKADEMIK,
NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË

Nr. rendor	Pozicioni	Paga
1	Rektor (titullar institucioni)	127500
2	Zëvendësrektor, nga kategoria “Profesor”	122400
3	Zëvendësrektor, nga kategoria “Docent”	120400
4	Dekan nga kategoria “Profesor”	122400
	Dekan nga kategoria “Docent”	120400
5	Zëvendësdekan, nga kategoria “Profesor”	109150
6	Zëvendësdekan, nga kategoria “Docent”	97000
7	Përgjegjës i njësisë bazë nga kategoria “Profesor”	109150
8	Përgjegjës i njësisë bazë nga kategoria “Docent”	97000
9	Profesor	105570
10	Profesor i Asociuar	91800
11	Docent	83650
12	Lektor i Parë/Kërkues i parë	80600
13	Lektor/Kërkues	64300